

NË ZBATIM TË UDHËZIMIT NR. 18, DATE 08/05/2020

Hapi i parë. Shqyrtimi i programit orientues. Evidentimi i temave për të cilat do të vlerësohet nxënësi në provimin e teorisë profesionale të integruar

Shih shembullin 1, në të cilin:

1. Duhet evidentuar temat të cilat janë zhvilluar përtej datës 9.03.2020 (gjenden të evidentuara me Highlight në shembull) dhe që NUK do të përfshihen në provimin e testit on line.
2. Duhet reflektuar ndryshimet e orëve dhe peshave si në tabelën 1.

Programi orientues Drejtimi Mësimor “Shërbime Mjetesh Transporti” Niveli II KSHK (niveli I AP)

Lëndët profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë:

Tabela 1 ishte: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Bazat e mekanikës për mjetet e transportit	48	18
2	Njohuri për mjetet e transportit	108	41
	Shërbime mjetesh transporti	76	29
	Elektroteknika dhe elektronika në mjetet e transportit	30	12
	TOTALI	262	100%

Tabela 2 bëhet: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Bazat e mekanikës për mjetet e transportit	37	18
2	Njohuri për mjetet e transportit	88	45
3	Shërbime mjetesh transporti	57	29
4	Elektroteknika dhe elektronika në mjetet e transportit	15	8
	TOTALI	197	100%

Temat nga lënda “Njohuri për mjetet e transportit”, kl.10 dhe 11:

Sistemet kryesore të mjeteve të transportit
Sistemi i ndezjes së MDB
Sistemi i ftohjes së MDB
Sistemi i vajisjes së MDB
Sistemi i ushqimit me injeksion të benzinës
Sistemi i ushqimit me injeksion të naftës
Burimet e energjisë elektrike në mjete transporti
Sistemi i lëshimit të motorit
Frekuenca e mjeteve të transportit
Kutitë shpejtëse në mjetet e transportit
Rrotullat e automjeteve
Sistemet e drejtimit të mjeteve të transportit
Sistemet e frenimit të mjeteve të transportit

Temat nga lënda “Elektroteknika dhe elektronika në mjetet e transportit”, kl.11:

Elementet elektrike dhe matja e tyre
Efektet e rrymës
Rreziqet dhe mbrojtja nga rryma elektrike
Elementet (simbolet) dhe llojet kryesore të skemave elektrike Ndriçuesit dhe sinjalizuesit
Pajisjet mbrojtëse (siguresat dhe automatët)
Pajisjet e komutimit, komandimit dhe rregullimit
Gjysmëpërçuesit
Elementet e qarqeve elektronike
Skemat bazë me gjysmëpërçues

Shënim:

Temat sipas lëndëve janë:

Temat nga lënda “Bazat e mekanikës për mjetet e transportit”, kl. 10 dhe 11:

Vetitë fizike, kimike, mekanike dhe teknologjike të materialeve
Materialet metalike
Lidhjet e metaleve
Mekanizmat tipike të makinave
Transmisionet (sistemet) tipike të makinave
Llogaritjet të thjeshta për statikën, kinematikën dhe dinamikën

Shtypja, tërheqja, përkulja, përdredhja dhe prerja
Ngarkesat e kombinuara
Përpunimi me prerje

Përpunimi me saldim dhe ngjitje

Përpunimi me heqje ashkle

Përpunimi axhusterik

Saktësia e punimit. Kuptimi dhe llojet e tolerancave të përmasave

Saktësia dhe ashpërsia e sipërfaqeve të detaleve

Temat nga lënda “Shërbime mjetesh transporti”, kl.10 dhe 11 :

Ndërtimi dhe funksionimi i një servisi automjetesh
Llojet dhe përshkrimi i dëmtimeve të detaleve dhe nyjeve në makina
Konsumimi dhe vajisja e detaleve dhe nyjeve të makinave
Metodat e riparimit të detaleve të makinave
Shërbimet e mirëmbajtjes në motorët e mjeteve të transportit
Punime të zëvendësimit në sistemin e vajisjes së motorit
Punime të zëvendësimit në sistemin e ftohjes së motorit
Punime të zëvendësimit në sistemin e ushqimit të motorit
Punime të zëvendësimit në burimet e energjisë elektrike
Punime të zëvendësimit në sistemin e ndezjes së motorit
Punime të zëvendësimit në sistemin e lëshimit të motorit
Shërbimet e mirëmbajtjes në transmisionet e mjeteve të transportit
Shërbimet e mirëmbajtjes në sistemet e drejtimit dhe frenimit të automjeteve
Punime të zëvendësimit në sistemet e drejtimit të automjeteve
Punime të zëvendësimit në sistemet e frenimit të automjeteve
Punime të zëvendësimit në sistemet ndihmëse të automjeteve

Hapi i dytë. Rekomandohet te ndërtohet tabela e shpërndarjes së pyetjeve, sipas peshave për cdo lëndë, bazuar në Programin Orientues të drejtimit mësimor sipas modelit më poshtë:

Shembull 2. Tabela e shpërndarjes së pyetjeve, sipas peshave për cdo lëndë, bazuar në Programin Orientues të drejtimit mësimor “**Shërbime mjetesht transporti**” niveli I (niveli II në KSHK)

Nr	Lëndët	Peshat e lëndëve në % dhe numri i pyetjeve për lëndë			Pyetjet e ndara sipas niveleve		Pikët sipas lëndëve
		% sipas PO (1)	Totali i pyetjeve (2)	Nr i pyetjeve për lëndë (3=1x2)	Niveli I Rikujtimi / Të kuptuarit	Niveli II Zbatimi / Analiza	
	Bazat e mekanikës për mjetet e transportit	18%	25	5	3	2	5
2	Njohuri për mjetet e transportit	45%	25	11	7	4	11
3	Shërbime mjetesht transportit	29%	25	7	5	2	7
4	Elektroteknika dhe elektronika në automjete	8%	25	2	1	1	2
	TOTALI			25 pyetje			25 pikë

Hapi i tretë. Hartimi i testit me 25 pyetje me alternativa, duke ju përmbajtur tabelës së dhënë në shembullin 2.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL
DHE KUALIFIKIMEVE

TEST

Drejtimin mësimor “**Shërbime mjeteve transporti**” niveli II në KSHK (niveli I AP)

1. Rrethoni përgjigjen e saktë. Çeliku i zakonshëm është:

(1 pikë)

- A) Lidhje e hekurit me gizën
- B) Lidhje e hekurit me kallajin
- C) Lidhje e hekurit me karbonin
- D) Lidhje e hekurit me natriumin

Përgjigje: C

2. Rrethoni përgjigjen e saktë. Një material quhet “lidhje metalike“ kur:

(1 pikë)

- A) Përmban një sasi të madhe hekur
- B) Nuk përmban fare hekur
- C) Është i përbërë nga dy ose më shumë metale
- D) Është i përbërë nga metale dhe jometale

Përgjigje: C

3. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga metodat e mëposhtme përdoret për të matur fortësinë e metaleve?

(1 pikë)

- A) Metoda martens
- B) Metoda rockwell
- C) Metoda tomson
- D) Metoda bernul

Përgjigje: B

4. Rrethoni përgjigjen e saktë. Sa/si është raporti i transmisionit të një transmisioni me rrota me dhëmbë cilindrike, kur rrotat motorike ka 12 dhëmbë dhe rrota rezistente ka 36 dhëmbë?

(1 pikë)

- A) 1/3
- B) 3
- C) I ndryshueshëm
- D) I papërcaktuar

Përgjigje: B

5. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili nga mekanizmat e mëposhtëm shndërron lëvizjen drejtvizore vajtje-ardhje në lëvizje rrotulluese? (1 pikë)

- A) Mekanizmi bjellë-manivelë
- B) Mekanizmi me gungë
- C) Mekanizmi me kulisë
- D) Mekanizmi me vidhë

Përgjigje: A

6. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në cilin mekanizëm bën pjesë freksioni i automobilin? (1 pikë)

- A) Mekanizmin e varjes
- B) Mekanizmin e transmisionit
- C) Mekanizmin orientues
- D) Mekanizmin shtytës

Përgjigje: B

7. Rrethoni përgjigjen e saktë. Sa procese kryhen, në një cikël të plotë të motorit me katër kohë? (1 pikë)

- A) 2 procese
- B) 3 procese
- C) 4 procese
- D) 5 procese

Përgjigje: D

8. Rrethoni përgjigjen e saktë. Sprucatori ndodhet në:

- A) Diferencial
- B) Pompën e benzinës
- C) Pompën e naftës
- D) Injektor

Përgjigje: D

9. Rrethoni përgjigjen e saktë. Guarnicioni me formë më të komplikuar është:

- A) Guarnicioni i kutisë së shpejtësisë
- B) Guarnicioni i kolektorit të shkarkimit
- C) Guarnicioni i kapakut të mekanizmit të shpërndarjes së gazeve
- D) Guarnicioni i kokës së motorit

Përgjigje: D

10. Rrethoni përgjigjen e saktë. Injektimi i naftës bëhet në:

- A) Karburator
- B) Pompën e naftës
- C) Kolektorin e thithjes
- D) Dhomën e djegies

Përgjigje: D

11. Rrethoni përgjigjen e saktë. Tensioni maksimal i punës në sistemin elektrik 12 volt (të autoveturës) është:

(1 pikë)

- A) 16 volt
- B) 14,5 volt
- C) 12 volt
- D) 10,5 volt

Përgjigje: B

12. Rrethoni përgjigjen e saktë. Sinkronizatori ndodhet në:

(1 pikë)

- A) Grupin e timonit
- B) Kutinë e ndërrimit të shpejtësisë
- C) Diferencial
- D) Freksion

Përgjigje: B

13. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cilët parametra ndryshon kutia e shpejtësisë në automobil?

(1 pikë)

- A) Fuqinë
- B) Shpejtësinë dhe forcën tërheqëse
- C) Vetëm forcën tërheqëse
- D) Vetëm shpejtësinë

Përgjigje: B

14. Rrethoni përgjigjen e saktë. Kur motori është i fikur, burimi i energjisë elektrike në automjet është:

(1 pikë)

- A) Rregullatori i tensionit
- B) Bateria
- C) Gjeneratori
- D) Alternatori

Përgjigje: B

15. Rrethoni përgjigjen e saktë. Nëse në motor do të mungonte volanti, atëherë:

(1 pikë)

- A) Pistonat do të lëviznin me vështirësi
- B) Pistonat do të lëviznin me lehtësi
- C) Pistonat do të ngecnin në pikat e vdekura
- D) Pistonat do të ngecnin gjatë rrugës (korsës)

Përgjigje: C

16. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në motorët me dy kohë, cikli i punës kryhet për:

(1 pikë)

- A) 1/2 rrotullimi të boshtit motorik

- B) 1 rrotullim të boshtit motorik
- C) 2 rrotullime të boshtit motorik
- D) 4 rrotullime të boshtit motorik

Përgjigje: B

17. Rrethoni përgjigjen e saktë. Punimet e mirëmbajtjes në motorin e mjetit të transportit:

(1 pikë)

- A) Parandalojnë defektet në detalet e motorit
- B) Rivendosin përmasat nominale të detaleve të konsumuara
- C) Shkurtojnë kohën e kryerjes së shërbimit teknik të motorit
- D) Ulin kostot e riparimit kapital të motorit

Përgjigje: A

18. Rrethoni përgjigjen e saktë. Defekti më i zakonshëm në boshtin e motorit është:

(1 pikë)

- A) Thyerja e boshtit motorik
- B) Përdredhja e boshtit motorik
- C) Konsumi i qafave të boshtit motorik
- D) Përkulja e boshtit motorik

Përgjigje: C

19. Rrethoni përgjigjen e saktë. Nëse presioni i vajit është i ulët, fillimisht duhet kontrolluar:

(1 pikë)

- A) Gjendja e pompës së vajit
- B) Gjendja e filtrit të vajit
- C) Niveli i vajit në rezervuar
- D) Numri i rrotullimeve të motorit

Përgjigje: C

20. Rrethoni përgjigjen e saktë. Si dallohet kabulli që lidhet me polin pozitiv të baterisë?

(1 pikë)

- A) Është më i trashë se kabulli që lidhet me polin negativ
- B) Ka veshje me ngjyrë të kuqe
- C) Nga shenjat "A", (+) ose "POS" që janë të shënuara në terminalin e tij
- D) Njëra nga alternativat më sipër

Përgjigje: D

21. Rrethoni përgjigjen e saktë. Përpara se të bëhen riparime në sistemin e ndezjes duhet që:

(1 pikë)

- A) Të karikohet bateria
- B) Të shkarkohet bateria
- C) Të stakohet bateria
- D) Të çmontohet bateria

Përgjigje: C

22. Rrethoni përgjigjen e saktë. Uji në sistemin e ftohjes së motorit mbinxehet kur: **(1 pikë)**

- A) Termostati qëndron i hapur
- B) Termostati është hequr nga foleja e tij
- C) Termostati nuk lejon qarkullimin e shkurtër
- D) Termostati nuk lejon qarkullimin e gjatë

Përgjigje: D

23. Rrethoni përgjigjen e saktë. Nëse një fermë (ndaluese) është e shformuar, ajo duhet të: **(1 pikë)**

- A) Ngrohet derisa të marrë formën e rregullt
- B) Përkulet me forcë në kahun e kundërt derisa të marrë formën e rregullt
- C) Zëvendësohet me një fermë të re
- D) Goditet me forcë në kahun e kundërt derisa të marrë formën e rregullt

Përgjigje: C

24. Rrethoni përgjigjen e saktë. Rezistenca elektrike matet me: **(1 pikë)**

- A) Vatmetër
- B) Voltmetër
- C) Ohmmetër
- D) Hertzmetër

Përgjigje: C

25. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në një qark të thjeshtë me një burim rryme dhe me një rezistencë, nëse dyfishohet vlera e Tensionit, atëherë: **(1 pikë)**

- A) Rezistenca zmadhohet dy herë
- B) Rryma zvogëlohet dy herë
- C) Rezistenca nuk ndryshon
- D) Rryma nuk ndryshon

Përgjigje: C